



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:128410

Datë: 08.07.2021

Numri i dokumentit: 01975296

PKR.nr.101/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Alban Ajvazi, me zyrtaren ligjore Jeta Asllani, duke vendosur në çështjen penale kundër të pandehurit F. B., për shkak të veprës penale Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.462/17b të datës 10.11.2017, jashtë seancës, në bazë të nenit 292 par. 1 lidhur me nenin 358 par.1 pika 1.3 KPPK-së, me datë **08.07.2021**, mori këtë:

A K T V E N D I M

H E D H E T aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, me numër PP.II.nr.462/17b të datës 10.11.2017 dhe,

PUSHOHET procedura penale, kundër të pandehurit:

F. B., nga i ati M., dhe nëna N., e gjinisë B., i lindur më ..., në P..., me vendbanim në lagjen D..., Hy..., kati ..., nr..., në P..., me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Për shkak se Prokurori i Shtetit është tërhekur nga aktakuza me numër PP.II.nr.462/17b të datës 10.11.2017.

Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë PP.II.nr.462/17b të datës 10.11.2017, ka akuzuar të pandehurin F. B., për shkak të veprës penale Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 të KPRK- së.

Prokurori i shtetit, i'u ka drejtuar gjyaktës me datë 08.07.2021, Për personin e njëjtë, për kohën, objektin dhe veprën e njëjtë penale, si në aktakuzën e lartshënuar, Prokuroria Themelore në Prishtinë paraprakisht ka ngritur Aktakuzë PP.I.nr.460/2017z, të datës 10.01.2018, e evidentuar në gjykatë me numër të lëndës PKR.nr.627/20. Duke vepruar sipas kësaj aktakuze, tani më gjykata ka nxjerrë Aktgjykim PKR.nr.627/20, të datës 22.02.2021, më të cilin të pandehurin F. B., e ka shpallur fajtorë dhe i ka shqiptuar dënim më gjorbë për veprën penale të lartcekur, si dhe ia ka konfiskuar armën.

Nga të cekurat më lartë, prokuroria vëren se në rastin konkret, për veprën e njëjtë penale, janë ngritur dy aktakuza për të pandehurin e njëjtë, ku në lidhje me Aktakuzën PP.I.nr.460/2017z është marr aktgjykim dënues në shkallën e parë, bazuar në nenin 4 të KPPK-së, tërhiqem nga ndjekja penale kundër të pandehurit F. B., në drejtim të veprës penale Mbajtja në pronësi kontrollë ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së, i akuzuar me datën 10.11.2017, sipas Aktakuzës PP.II.nr.462/17b, pasi që lidhur me të njëjtën çështje penale veç është duke u zhvilluar procedura penale dhe është marr aktgjykim në shkallën e parë.

Mbi shpenzimet e procedurës penale është vendosur ne bazë të nenit 454 paragrafi 1 të KPPK-së

Nga të dhënat e paraqitura më lartë gjykata konstaton se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore që kundër të pandehurit të hedhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale, prandaj në pajtim me nenin 292 par. 1 lidhur me nenin 358 par.1 pika 1.3 KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE – DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË
RËNDA ,**

2019:128410, 08.07.2021

G j y q t a r i

Alban Ajvazi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa dhe mund të ushtrohet nga palët e autorizuara brenda tri (3) ditëve, nga dita e pranimit, përmes kësaj gjykate, duke ju drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë.